Autoriteti Portual Durres
DURRES PORT AUTHORITY

APD: Kroçerat e këtij viti në portin e Durrësit, nga muaji shkurti në nëntor

5 shkurt 2019




Sezoni turistik në portin e Durrësit këtë vit do të nisë më shpejt dhe do të zgjasë mbi 9 muaj.
Deri tani në APD është njoftuar mbërritja e 25 kroçerave dhe velierave turistike, të cilat do ta vizitojnë qytetin e Durrësit nga muaji shkurt deri në nëntor të këtij viti.
Kroçera “La Belle De LAdriatique”, që pritet të mbërrijë më 19 shkurt në Durrës, gjatë periudhës shkurt-prill 2019 do të ankorohet 7 herë radhazi në kalatat e portit më të madh të vendit-bëjnë të ditur burime nga Qendra e Informacionit në APD.
Përveç kroçerave në Durrës pritet të ankorohen edhe një numër shumër shumë më I madh jahtesh turistikë të përmasave të ndryshme.
Kroçera “La Belle De LAdriatique” ka ardhur dy herë të tjera në portin e Durrësit përkatësisht në vitet 2017 dhe 2018.

Adresa: L. 1 “Rruga Tregtare “, Durres; Tel. +355 52 293402 Tel/Fax +355 52 223115
ëeb : ëëë.apdurres.com.al e-mail: info@apdurres.com.al